



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
**Kuvendi i Komunës Rahovec**  
Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly of Rahovec



**PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **30.05.2024**, me fillim në orën **10:10**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Arbër Zenuni**. Në fillim kryesuesi konstatoi kuorumi për mbajtjen e mbledhjes ekziston. Në fillim të mbledhjes, nga 31 anëtarë, të pranishëm kanë qenë 24.

**Kryesuesi:** Përvendetje për të gjithë! I nderuar Kryetar i Komunës, **z. Smajl Latifi**, Nënkyetar **z. Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtore të drejtorive komunale, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, medie, të nderuar qytetarë të Komunës së Rahovecit. Për këtë mbledhje të pestë të vitit 2024, së bashku me kryetarin, kemi vendosur për këtë rend dite:

**REND DITE**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; Nr. Bl./Nr. Bz./Nr. Bz. /Kuvendi i Komunës) 66  
Nr. Bl./Nr. Bz./Nr. Bz. /Kuvendi i Komunës) 236/24 Nr. i tag/Bz.str/Nr. pg.  
25.06.2024
2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e vendimit për shpalljen “**QYTETAR NDERI**” të Komunës së Rahovecit, z. Pandeli Majko, ish-kryeministër i Republikës së Shqipërisë;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për themelimin e Shtëpisë-muze të dy heronjve të Kosovës, Bedrush dhe Feim Gashit;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, personave fizikë dhe juridikë nga 1 (një), deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, P- 01039-0, zk- Xërxe;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe përvlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P- 01039-0, zk-Xërxe;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për konstituimin e të drejtës së servitutit sendor (të drejtës së kalimit) në parcelat publike P-71510057-02680-1 dhe P-71510057-02680-2, zk - Rahovec;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për konstituimin e të drejtës së servitutit sendor (të drejtës së kalimit) në parçelen publike kadastrale, sipas certifikatës së pronësisë, P-71510032-00069-0, zk-Zoqishtë;
8. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve.

**Defrim Kafexhiu:** Përvendetje për të gjithë! I nderuar kryesues, kryetar, nënkyetar, anëtarë të kuvendit, drejtore, media, të pranishëm. Sikur në seancat e kaluara, përsëri propozoj që pika e fundit e rendit të ditës, (pyetjet dhe përgjigjet në pyetjen e kuvendarëve) të rikthehet aty ku ka qenë më herët, si e dyta në rend dite. Besojmë që, më herët ka qenë më mirë dhe kanë funksionuar më mirë seancat. Gjithashtu, besoj që ishte një vendim i gutshëm i kuvendit komunal dhe një propozim tendencioz i anëtarëve të Aleancës, që kjo pikë të vendoset e fundit. Në dy seancat e kaluara e kemi parë që me format të tillë, që në fund të rendit të ditës të mbahen diskutimet, ka qenë më

pak produktiv sesa më herët. Propozoj të vendoset në votim, ose me mirëkuptim të vendoset si pikë e dytë në rend dite.

**Kryetari:** Kryesues i nderuar, anëtarë të kuvendit, drejtorë të drejtive. Unë jam dakord, por, nëse ka mundësi prej muajit qershori. Sot e kemi familjen Gashi këtu në kuvend. Nga qershori, pika e dytë e rendit të ditës është pyetje, përgjigje dhe diskutimet e kuvendarëve. Për mua, nuk më pengon as në fillim, as në fund. Nuk ka pasur tendencë asnjëherë t'i ikim ballafaqimeve, sepse është e nevojshme të kemi ballafaqime. Nëse ne kemi dëshirë të pranojmë vlerësimë pozitive, atëherë duhet t'i pranojmë edhe kritikat. Propozoj që prej seancës së radhës të rikthehet pika standarde si e dyta me radhë.

**Burim Krasniqi:** Faleminderit kryesues, ekzekutiv, kolegë asambleistë, monitorues, të pranishëm. Fillimi, falënderoj të gjithë prej kryesisë të klubit të hendballit Rahovecit, stafin teknik, hendballistët, sportdashësit dhe të gjithë ata që më në fund na kanë dhënë një lajm të mirë, që KH. Rahoveci është shpallur kampion i Kosovës. Urime hendballistëve dhe henbolldashësve! Uroj që në të ardhme të kemi fitore tjera. Kryesues, dola të deklarohem për një çështje jashtë rendit të ditës. E kemi pasur një diskutim me drejtorin e gjeodezisë - kadastrës, rreth një pronë të usurpuar e cila është vendosur në seancën e kaluar. Kemi pasur një tendencë rreth asaj që unë të dukem si manipulues në seancë. Në KPF, drejtori i urbanizmit thotë: "E kam për obligim moral dhe ligjor, këtu nuk prezentoj pikë, që të përmendi që personi fizik apo juridik është usurpator. Nuk është usurpator, nuk ka vendim për usurpim." Kjo është thënë në KPF dhe në seancën tha që nuk kam thënë kështu. Unë dola për shkak të korrektësisë që nuk manipuloj dhe nuk them diçka që nuk është thënë në KPF. Në seancë ka ardhur materiali, që me të gjitha procedurat është vlerësuar si usurpator. Është një pikë e mbyllur që nuk tenton të kthehet pas, por është një çështje që mos të tentohet që asamblesitët të duken si diçka që po manipulojnë. Ka komplet sjellje të ndryshme prej KPF-së në seancë. Në KPF është thënë që nuk është usurpator me letra, në seancën ka ardhur materiali që është usurpator dhe del drejtori thotë që nuk e kam thënë. E them troç dhe me përgjegjësi, kur flas diçka nuk "rrej". Keni kujdes diçka që na thoni, sepse procesverbalet ekzistojnë. Lexoni faqen 3 të procesverbalit të KPF-së dhe procesverbalin e seancës gjatë diskutimit të asaj pike të rendit të ditës. Ju lutem, të trajtohet asambleisti si ligjvënës dhe jo si instrument.

**Afrim Oruqi:** Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, kolegë drejtorë, anëtarë të kuvendit. Falënderoj Sekretariatin që është kujdesur për procesverbal dhe për çdo punë që e bën. Në atë seancë edhe sot gjithashtu, ju them që në kohën kur ju kam prezantuar materialin në KPF dhe në kuvend, kjo pronë nuk ka qenë e usurpuar. Qëndroj pas çdo pike dhe presje që e kam thënë. Nuk vendosi propozime të kryetarit të komunës këtu në kuvend, që të marrim vendim për pronat komunale të usurpuara. Të gjitha ato që i ka deklaruar asambleisti Burim Krasniqi, pas pyetjes, ia kam përshkruar në email çdo letër zyrtare. Pasi që ka filluar ndërtimi në atë parcelë private, kur e ka prekur pronën publike, menjëherë ka intrevevuar inspektorati. Më pas, kemi dalur në terren dhe kemi konstatuar që është prekur pronë publike. Kemi nxjerrë vendim për usurpim, por kjo ka ndodh vitin e kaluar. Pas këtij vendimi, pronari është obliguar që pronën komunale ta lirojë. E ka liruar dhe e ka mbushur me zhavorr. Kronologjikisht po ju tregoj që në kohën kur e kam prezantuar në KPF, nuk ka qenë pronë e usurpuar. Kur është liruar pronë publike, sektori i pronës dhe gjeodezisë ka marrur vendim dhe e ka ndërpërë procedurën për usurpim. Kjo ka ndodh para seancës së KPF-së dhe pronari i pronës private aty, nuk është cilësuar më si usurpator dhe pas nuk e di sa muajve, pasiqë pronë publike ka qenë e lirë, pas kërkesës së palëve e kemi vendosur propozim vendim të ri për ta dhënë me qera. Ju garantoj juve, ligjërisht dhe moralisht, që kur ju kam prezantuar juve për ta marrur vendimin, pronë nuk ka qenë e usurpuar. Nuk mundem unë që të njëjtën kohë t'ju them juve, "hajdeni merrni vendim" përderisa ekziston vendimi për usurpim. Unë nuk "rrej" dhe nuk beson që dikush këtu "rren".

**Kryetari:** Unë i kuptoj pyetjet dhe shqetësimet që bëhen para rendit të ditës. Por, ta kemi të qartë, që në pikën e dytë që do të jetë menjëherë pas procesvebalit, t'i parashtroni pyetjet për ekzekutivin. T'i përbahemi pak, përndryshe 2-3 orë i humbim. Sa i përket atyre që nuk vijnë dhe që vonohen në seancë, duket ta dinë cili është orari, sa është paga e anëtarëve dhe cili është roli i tyre. Mirë që nuk jam ministër i financave, se unë e di se çka duhet të bëj në raport me asamble të tillë, që nuk paralajmërojnë për vonesat dhe mungesat e tyre. Nuk ka ndodhur dhe nuk ndodh që kryetari me ekzekutivin, t'i pres asambleistët tjerë për seancë. Nëse jeni dakord nga seanca e radhës, pyetjet dhe përgjigjet t'i paraqitni në pikën e dytë të rendit të ditës. Mendoj që debati i mëtutjeshëm para miratimit të rendit të ditës, vetëm që na humbë kohë.

Gjithashtu edhe unë e uroj klubin e hendbollit për titullin kampion. E kemi këtu edhe Bejtullahun, njërin prej atyre që ka kontribuar shumë. Në të ardhmen duhet të mendojmë se si klubin ta mbështesim sa më shumë, që ta ruajmë titullin. I bashkohemi propozimit të Defrimit, që nga seanca e radhës, pika e fundit të kalojë në pikën e dytë.

**Kryesuesi:** Faleminderit kryetar! Atëherë, propozimin e Defrimit e vendosim në votim. Që pika e fundit (pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet), nga qershori të vendoset si e dyta. Kush është “për”... Kundër?... Abstenim?... Me 19 vota “për” dhe 3 kundër, aprovohet propozimi. Tani e vendosim rendin e ditës në votim, kush është “për”?... Unanimisht votohet rendi i ditës (24 “për”).

### **1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Kryesuesi:** Nëse dikush ka ndonjë vërejtje rreth procesverbalit?... Nëse jo, kush është “për”?... Unanimisht, me 24 vota “për” votohet pika e parë.

### **2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e vendimit për shpaljen “QYTETAR NDERI” të Komunës së Rahovecit, z. Pandeli Majko, ish-kryeministër i Republikës së Shqipërisë;**

**Kryetari:** Faleminderit kryesues, anëtarë të kuvendit, drejtore të drejtive, nënkyetar, përfaqësues të mediave. Nuk dua ta zgjas, e keni materialin afër. Z. Pandeli Majko është qytetar i njohur për të gjithë shqiptarët e Kosovës dhe posaçërisht për ata që kanë përjetuar angazhimin dhe mbështetjen që iu ka dhënë në cilësinë e kryeministrat, në kohën e luftës për çlirimin e Kosovës. Në Kukës kanë qenë rreth 700.000 qytetarë të dëbuar me dhunë nga forcat serbe dhe roli i një kryeministri si Pandeli Majko ka qenë i jashtëzakonshëm, duke mos e mohuar asnijëherë kontributin e qytatarëve bujarë të Kukësit, të Hasit, Krumës dhe të donatorëve, të cilët janë kujdesur për sigurimin e ushqimit, mirëmbajtjes, në logistikë etj... Përveç që si kryministër që ka kontribouar në trajtimin e një gjendjeje të rëndë të krijuar në mars, prill, maj, të vitit 1999, në raport me të dëbuarve me dhunë, njëkohësisht ka luajtur edhe një rol në luftën për çlirimin e Kosovës. Aktualisht, z. Pandeli Majko është deputet i kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Ne jemi në 25 vjetorin e çlirimit, si komunë dhe si Kosovë. Nga komuna jonë, janë me qindra (7-8 mijë) që kanë qenë në Kukës. Gjithashtu është edhe vullnet i organizatave të dala nga lufta që z. Pandeli Majko të shpallet qytetar nderi. Ju ftoj t'i jepni komentet e juaja dhe me 14 qershori, në Ditën e Çlirimit të Rahovecit, do ta kemi Pandeli Majkon në seancë solemne dhe do t'i dorëzohet titulli.

**Burim Krasniqi:** Kryetar, faleminderit për propozimin! Pata pyetje, megjithëse na dhe përgjigje që Pandeli Majkon do ta kemi present këtu, më 14 qershori. A duhet të votohet ose jo, nuk besoj që duhet të kemi diskutime për këtë çështje, sepse është i paarsyeshëm mosvotimi i një votimi të tillë. Besoj që shefat e grupeve do ta shfrytëzojmë rastin për një fjallë rasti, kur do ta kemi prezent edhe ish – kryministrin, Pandeli Majkon.

**Kryesuesi:** Nëse nuk kemi diskutime tjera, pikën e dytë e kalojmë në votim. Kush është “për”?... Unanimisht, me 24 vota pro, votohet pika e dytë.

### **3. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për themelimin e Shtëpisë-muze të dy heronjve të Kosovës, Bedrush dhe Feim Gashit;**

**Kryesuesi:** Të nderuar anëtarë të kuvendit, me prezencën e tyre na kanë nderuar: Isuf Gashi, nëna e dëshmorëve Bedrush dhe Feim Gashi, nëna Bademe dhe qytetarë nga Drenoci. Mirë se keni ardhur që të diskutojmë rreth pikës së tretë, miratimi i vendimit për themelimin e Shtëpisë-muze të dy heronjve të Kosovës, Bedrush dhe Feim Gashit.

**Kryetari:** Kuvendit të Komunës së Rahovecit, besoj që rrallë i ndodh të nderohet kaq shumë. Kësaj radhe, në historinë e pasluftës, e kemi nënën e dy heronjve, Bedrushit dhe Feimit, djemt e Bedrushit dhe familjarët tjerë, vëllezërit, baca Isuf. I urojmë shëndet nënës Bademe, e cila me dëshirë të flaktë ka ardhur të na dëgjojë se a jemi ata që po bëjmë diçka të mirë dhe të ndershme për idealin e bijve të saj. Një sqarim: Unë do ta paraqes arsyetimin, do t'i ftoj përgjegjësit e grupeve politike për deklarim dhe në procesin e votimit, për shkak të principeve që kanë institucionet, do t'i lirojmë familjarët, sepse sipas ligjit, në votim nuk parashihet një gjë e tillë. Sugjerimi i sekretarisë së kuvendit është që vetëm në aktin e votimit, kuvendi të votojë dhe përsëri kthehemë në sallë për një duartrokës së bashku. Sot, jemi shumë të gjëzuar që në rendin e ditës e kemi propozim-vendimin, i cili do të miratohet në kuvend për themelimin e Muzeut të UÇK-së në Drenoc. Përkatësisht, themelimin e odës së bacës Avdi Gashi. Arsyetim: Më 26 prill 1998, në Drenoc të Komunës së Rahovecit doli hapur Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Celula e parë e UÇK-së kishte vite që funksiononte dhe përgatitjet përluftë të armatosur çlirimtare, bëheshin me intensitet. Takimet dhe planet operative mbaheshin në odën e Avdi (Sherif) Gashit, pasi që dy bijtë e tij, Bedrush dhe Feim Gashi, ishin pjesë e strukturës organizative të UÇK-së në Rajon. Drenoci ka qenë bazë e rëndësishme e UÇK-së deri në shtator të atij viti. Shtëpia e Avdi Gashit mori rëndësi stretegjike, pasi aty u vendos

Shtabi Rajonal i UÇK-së, që drejtohej nga operacionet luftarake në tërë rajonin e Anadrinisë dhe më gjërë. Në këtë shtëpi kanë qëndruar strukturat më të larta drejtuese të UÇK-së, si dhe janë marrë shumë vendime me rëndësi për mbarëvajtjen e luftës çlirimtare. Në këtë vend, zunë fill dhe u formuan 5 brigada operative të UÇK-së, në Zonën Operative të Pashtrikut. Brigada 121, që operonte në një pjesë të Komunës së Malishevës dhe në një pjesë të Komunës së Lipjanit. Brigada 122, që operonte në një pjesë të Komunës së Malishevës dhe të Klinës. Brigada 123, që operonte në Komunën e Therandës. Brigada 124, që operonte në Komunën e Rahovecit. Brigada 125, që operonte në Komunën e Prizrenit. Brigadat: 126, 127, 128 ishin të dedikuara për mbështetje logjistike të luftës për çlirimin e Kosovës. Qëllimi i themelimit të Shtëpisë-muze, Odës së Avdi Gashit, është grumbullimi, selektimi dhe ruajtja e dokumenteve dhe gjësendeve tjera të trashëgimisë së luajtshme me peshë të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Komunën e Rahovecit, si celucë e parë e UÇK-së. Muzeu do t'i organizojë njësitë përkatëse organizative me punonjës të kualifikuar, të cilët do ta përgatisin statutin dhe aktet tjera normative dhe të cilat do të dërgohen për miratim në kuvendin e komunës. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset, kryetari i komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit. Pas miratimin nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në MAPL, duke u bazuar në nenin 81 të ligjit Nr 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe nenin 8 lidhur me nenin 9, të rregullores Nr 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunës, e ndryshuar dhe plotësuar me rregulloren QRK Nr 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose në ueb-faqen zyrtare të komunës. Falënderojmë gjakun e dy heronjve, Bedrush dhe Feim Gashi dhe gjakun e derdhur për liri të qytetarëve dhe bashkëluftëtarëve nga Drenoci dhe komuna jonë.

**Hasan Përboqi:** I uroj mirëseardhje nënës Bademe, nëna e dy heronjve, Bedrush dhe Feim Gashi, anëtarëve të tjerë të familjes së ngushtë, ju bashkëfshatarë të Bedrushit dhe Feimit. I nderuar kryetar, nënkyetar, kryesues, kolegë, drejtore, qytetarë. Është fakt i pamohueshëm që sot, kuvendi i komunës nuk i bën nder familjes së Bedrush dhe Feim Gashit. Është familja e tyre që na bën nder neve dhe i ka bërë nder gjithë Kosovës. Për Bedrushin e Feimin, neve gjeneratave të reja, na flitet me dashamirësi dhe krenari. Deri në momentin e përjetësimit të tyre, ata ishin vetëm të nënës Bademe e Bacës Avdi. Nga momenti momenti i përjetësimit, ata janë djemt më të zotë të kësaj Kosove. Ky vendim i sotëm është një hap i rëndësishëm, sepse shtëpia e bacës Avdi dhe nënës Bademe, zyrtarisht shëndrrohet në një Shtëpi-muze, që përmes saj, e gjithë bota mbarë do të mund të kuptojë gjenocidin e ashpër që ka ushtruar populli serb ndaj qytetarëve të pafajshëm të kësaj treve. Ne si grup, vendimet e tilla i presim me krenari, sepse na bëjnë krenarë, ashtu edhe ndihemi.

**Defrim Kafexhiu:** Të nderuar familjarë të Feim dhe Bedrush Gashit! E nderuar nënë heroike, Bademe! I nderuar Bac i Drenocit. Për qudi, kanë kaluar 3 vite të këtij mandati dhe sot kam emocione dhe po ndihem shumë i nderuar, që sot, e kam nderim që për këtë pikë të rendit të ditës ta flas një fjal të rastit. Sot ndihem edhe më shumë i nderuar, kur për krahe jam me nënën e dy heronjve të Komunës sonë, Feimit dhe Bedrushit. Në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, ndihemi shumë krenarë që do ta marrim një vendim dhe do të themelojmë Muzeun e UÇK-së në Drenoc. Në Drenocin heroik të Feimit dhe Bedrushit, do ta bëjmë shtëpinë-muze të Avdi Gashit. Drenoci ishte hambar i armatimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Prej sot, do t'ju tregojmë të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, gjeneratave të reja, që do të mund ta vizionjnë një vend, i cili gjatë luftës është vizituar nga figurat më eminente të UÇK-së. Në atë shtëpi të Bacës Avdi kanë fjetur figurat, kokat e Ushtrisë Çlirimtare, që sot, fatkeqësisht disa prej tyre janë në burgje, që po i përndjek ende dora e padrejtë – 25 vjet pas luftës. Ndoshta nuk jam shumë orator që ta mbledhi këtë nderim që po më bëhet mua. Sot po e ndiej mungesën e profesorit Sabahajdin Cena, i cili në këto momente do të fliste diçka shumë më ëmbël dhe më mirë. Para jush po e recitoj një paragraf: ... dhe krisën pushkët e para, u prenë dy lista t'blinit.

Cilin ta vajtoj, unë nana, Bedrushin a Feimin?

Ndihmom Gjyl, e motër, Xhelalin a Sadedinin?

Në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, e mbështesim fuqishëm vendimin për themelimin e Muzeut të UÇK-së në Drenocin heroik. Falënderoj kryesuesin për mundësinë, si dhe kryetarin për kontributin e tij në promovimin e vlerave të luftës edhe pas kalimit të një qerek shekulli prej saj. Lavdi të rënëve përlirinë e Kosovës.

**Burim Krasniqi:** Faleminderit kryesues! Faleminderit për prezencën, nënë Bademe, familjarë të heronjve Bedrush e Feim Gashi, Baca Isuf, të gjithë të pranishmit këtu. Të flasim edhe dy ditë, nuk besoj që është e mjaftueshme për ta përshkruar ndjenjën, momentin dhe privilegjin që na është dhënë neve, që të marrim një vendim që ta shpallim

shtëpi-muze shtëpinë e bacës Avdi. Nuk po flas një emër të një grupei politik, por si qytetar i Kosovës dhe nuk besoj që ka ndonjë qytetar, i cili nuk ish ndjeh mirë që të jetë prezent sot në sallën e asamblesë komunale. Privilegji dhe ndër për ne. Dua ta falënderoj familjen e heronjeve, e cila përpos që i dha dy djemt e tyre, sot e jep edhe trollin dhe odën e tyre, që heroizmi dhe lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të prezantohet sot e përgjithmonë, para brezave dhe gjeneratave të tjera që vijnë pas. Është dëshmi shumë e mirë, që përkundër disbalancit të forcave ushtarake, trimëria dhe guximi i djemve dhe vajzave shqiptare nuk ka munguar asnjëherë. Uroj që nënën Bademë ta takoj në të mira dhe gjëzime, si dhe besoj fuqishëm që kjo do t'i mbanë edhe më fuqishëm emrat e ty heronje të komunës tonë. Lavdi heronje dhe dëshmorëve. Faleminderit secilit ushtar të UÇK-së që e ka pasur pushkën për çlirimin e vendit tonë, sepse ajo ka bërë që ne sot të jemi këtu.

**Bejtullah Deliu:** Faleminderit kryeues! E nderuara familje Gashi, bac, nënëloke Bademë. Prej momentin kur hyri nënë Bademë këtu, më ktheu në retrospektivë kur isha i ri, nënët si kjo janë ato nëna që na kanë dhënë kurajo. Kur e sheh sot këtë liri, këtë frysëmarrje që sot e marrim, jam i sigurtë që po të kishte edhe njëqind jetë edhe njëqind herë do t'i jepte bijtë e saj për këtë liri që ne e gjëzojmë, nuk ka këtu mëdyshje. Të flas unë për Drenocin, mund të flas vetëm duke u bazuar në biseda që i kemi zhvilluar me shokë të mi që kanë qenë ushtarë. E përmendi Defrimi, profesorin Sabahajdin Cena, me të cilin kam pasur fat të bisedoj rrëth luftës, sepse më ka interesuar shumë. Sot do të ishte një atmosferë pak më ndryshe e fjali meve, ne mund vetëm t'i përqojmë ato. Ata që i kanë përfjetuar flasin më me emocione. Drenoci njihet si arterie kyqe për çlirimin e Kosovës në tërsi, jo vetëm në komunën tonë. Në Drenoc janë zhvilluar figura bukur të mëdha, të cilët nuk janë në mesin tonë, por do të jetojnë çdo herë. Dëshmorët jetojnë sa vetë historia. Unë gjithashtu do të lutesha të isha në vendin e tyre, sepse një herë në shekull të vjen një rast i tillë, të tregohesh apo të dëshmohesh për vendin tënd. Shtëpia-muze do të jetë një shembull se si është organizuar UÇK-ja. Se sa kanë qenë të gatshme nënëtona të sakrifikojnë një pjesë të shpirtit të tyre, t'ja dhurojnë kësaj toke të përgjakur, vetëm e vetëm që brezat tjerë të jetojnë dhe të zhvillohen në liri. Drenoci është vetë historia dhe nuk duhet lejuar që të zbehet historia. Sa më shumë muze dhe sa më shumë pika ku mund t'i tregojmë gjeneratave se ku ishim dhe ku jemi, aq më shumë do të jemi si shtet më i fortë. Uroj që edhe çlirimtarët që janë duke u gjykuar padrejtësish, të lirohen, sepse ata janë vetë historia dhe vetë UÇK-ja. Lavdi heronje, Bedrush dhe Feim Gashi!

**Sejfullah Sejfullahu:** Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkyetar, kolegë asambleistë. Shumë e nderuar nëna Bademe, familja e heronjeve Bedrush dhe Feim Gashi, baca Jusuf. Kam dy arsyet që dola këtu. Në Drenoc kam parë shumë flakë dhe flakë gjëzimi. E para, është mirë që shtëpia-muze po bëhet shtëpia e bacës Avdi dhe e dyta, është që unë në atë shtëpi kam ngrënë shumë herë bukë, para luftës, në luftë dhe pas luftës. I kam dy kujtime që kam qejf t'i shpalosi me ju. Më kujtohet 26 prilli, kur filloj ndryshimi i historisë, aksioni në Krushë të Vogël. Nuk dua t'ju them që unë kam qenë pjesë e atyre luftimeve heroike, por kam qenë pjesë e aktivitetit që më ka bërë ndër dhe Feimi pas atyre luftimeve, vjen te unë në shtëpi dhe vazhdojmë për Drenoc. Me Bedrushin më kujtohet që është dashur të shkojmë në Zatriq te Agim Spahija për të marrur armatim. E kam pas një kombi-bus jeshil dhe jemi nisur me Bedrushin dhe Milaim Gashin në Zatriq, duke u kthyer, rrugës kemi ra në pritë. E kaluam disi dhe kemi shkuar te dajtë e Florimit në Shkozë (Mllanaviq). Më kujtohet një gjë, kanë qeshur shumë. Nana Bademe, jam shumë i lumtur që ajo shtëpi që kemi ngrënë bukë, unë dhe shumë çlirimtarë të tjerë dhe që sot janë në grila dhe shumë dëshmorë e hero. Aty kam marrur ajër dhe motiv, siç po marr tanë në këtë moment. Duke pasur parasysh që me këtu duar keni larë e ushqyer shumë ushtarë, gjithashtu kam ngrënë edhe unë bukë, jam i nderuar që para votimit, t'i puth ato dy duar të bekuar. Lavdi luftës heroike.

**Jusuf Gashi:** Ju pëershëndes të gjithëve, pa dallim! E pëershëndes kryetarin e komunës me staf, kryesuesin e kuvendit, asambleistët, drejtoret. Kam respekt të veçantë për këtë iniciativë. Është shumë e vërtetë që Avdi Gashi me kunitatën time, Bademën, i kanë rritur tetë fëmijë me mund të madh, të gjithë të shkolluar, tri vajza dhe pesë djemë. Është e vertetë që është themeluar një celulë e hershme e UÇK-së, me Mensur Zyberajn dhe vëllezerit Gashi dhe ka marrur përmasa të gjëra. Oda e Avdi Gashit ka qenë bazë e fuqishme e UÇK-së në shërbim të luftës për çlirim. Kunata iu ka dhënë bukë të gjitha strukturave të larta, prej Fehmi Lladrovçit, Mujë Krasniqit dhe të gjithë të tjerët që kanë qenë aty. I kemi pasur lidhjet edhe me Dukagjin dhe Drenicë. Jam mirënjohës për këtë, falënderoj kryetarin e komunës dhe kuvenden – institucionin më të lartë, për këtë iniciativë madhështore. Unë jam vëllau i Avdisë, shumicë ndoshta nuk e dinë, por ai më ka frysëzuar edhe mua. Fëmijët e Avdisë, i madh e i vogël,

kanë qenë në shërbim të UÇK-së. Ju përshëndes të gjithëve, në veçanti kunatën, nënën Bademe. Kryetar, faleminderit që po e nderoni familjen e Avdi (Sherif) Gashit.

**Kryetari:** E luta Skenderi, Shefin e Zyrës së Kuvendit, që është dakorduar me MAPL-në dhe që në situata të tilla kur të gjithë janë “për” një vendimi, në këtë rast për themelin e muzeut, nuk prish punë që edhe në ceremoninë e votimit familjet të jenë të pranishme. Falënderoj të gjitha grupet politike dhe qytetarët e komunës. E jona mbetet që aty të kemi njerëz të fushës dhe që të dinë ta plasojnë të vertetën e ndodhur para vizitorëve të brendshëm e të jashtëm. Qoftë i përjetshëm Muzeu i UÇK-së në Drenoc. Pastë shëndet dhe qoftë krenare nëna Bademe, vëllezër, motrat dhe fëmijët e Bedrushit e Feimit.

**Kryesuesi:** Faleminderit kryetar! Të nderuar të pranishëm, kemi ardhur te momenti i votimit për pikën e tretë: Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për themelin e Shtëpisë-muze të dy heronjve të Kosovës, Bedrush dhe Feim Gashit. Kush është “për”?... Unanimisht me 24 vota pro, votohet pika e tretë e rendit të ditës... Vazhdojmë me një pauzë 10 minutshe.

**4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, personave fizikë dhe juridikë nga 1 (një), deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, P- 01039-0, zk- Xërxe;**

**Erhan Morina:** Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkyetar, drejtorë, anëtarë të kuvendit, media. Kemi propozim-vendimin e kryetarit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, 01039-0, zk- Xërxe, me sipërfaqe  $6506m^2$ , ku nga kjo sipërfaqe ndahan dhe jepen në shfrytëzim vetë  $950m^2$ . Afati i dhënies në shfrytëzim është deri në 15 vite. Kjo parcelë momentalisht është e dhënë në shfrytëzim, kontrata i skadon me 3 korrik dhe për shkak të procedurave të ankandit publik, kemi konstatuar që është e nevojshme që këtë pikë të rendit të ditës ta iniciojmë në muajin maj.

**Burim Krasniqi:** Nuk kam diçka në lidhje me vendimin, por, e kam një kërkesë te drejtori dhe te komisioni në të ardhmen. Besoj që përvèç të të hyrave, është mirë ta kemi në konsideratë edhe pjesën e investimeve. Kur thirremi në një vendim që për qëllim e kemi ruajtën dhe rritjen e vlerës së pronës, në procesin e dhënies në shfrytëzim duhet ta shohim mundësinë e balancimit në mes qirasë dhe pjesës së investimeve.

**Defrim Kafexhiu:** Drejtor, meqenëse kontrata është aktive deri më datë 3, a ka të drejtë që personi që e ka pasur në shfrytësim deri tani, ta merr përsëri, apo mund ta fitojë dikush tjetër?

**Erhan Morina:** Te pyetja e Burimit: Ajo pjesë ku bëhet fjalë për këtë parcelë, me PZhK është e paraparë që lejohet edhe investimi në atë zonë. Te pyetja e Defrimit: Po, gjithësesi që kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë qytetarët që i plotësojnë kriteret.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! Nëse nuk kemi diskutime të tjera, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Me 25 vota “për” votohet pika e katërt e rendit të ditës.

**5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe përvlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P- 01039-0, zk- Xërxe;**

**Erhan Morina:** Kjo pikë ndërlidhet me pikën paraprake për dhënien në shfrytëzim të parcelës të lartëcekur. Komisioni përbëhet prej pesë anëtarëve, dy nga ekzekutivi, dy nga legjislativi dhe një nga sektori joqeveritar.

**Kryesuesi:** Ftoj grupet e partive për propozimet e tyre.

**Ilir Pallqa:** LVV, Defrim Kafexhiu.

**Hasan Përboqi:** AAK, Feriz Thaqin.

**Sejfullah Sejfullahu:** PDK, nuk kemi kandidat.

**Burim Krasniqi:** LDK, nuk kemi propozim.

**Kryesuesi:** Faleminderit! Atëherë, nga kuvendi i komunës komisionin e përbejnë Defrim Kafexhiu nga LVV dhe Feriz Thaqi nga AAK. Nga ekzekutivi janë Besmire Bytyqi dhe Erhan Morina dhe një përfaqësuese nga OJQ-të. E vendosim si të tillë në votim! Kush është “për”?... me 25 vota “për” votohet edhe pika e pestë.

**6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për konstituimin e të drejtës së servitutit sendor (të drejtës së kalimit) në parcelat publike, P-71510057-02680-1 dhe P-71510057-02680-2, zk - Rahovec;**

**Afrim Oruqi:** Faleminderit kryesues! Të nderuar kuvendarë, para jush keni propozim-vendimin për konstituimin e të drejtës së kalimit nëpër dy parcela komunale me nr. 2680-1 dhe 2680-2, në sipërfaqe prej 52 ari e 59m dhe në sipërfaqe tjetër prej 367m prej sipërfaqes së përgjithshme. E drejta e kalimit nëpër këto dy parcela komunale, iu

takon parcelave që janë pa rrugë dhe pa dalje në rrugë publike. Rruga është në gjerësi prej 4m. Në jug-perëndim, gjatësia e përgjithshme e kësaj të drejte është 122.03m dhe në lindje-jug gjatësia është 121.37m.

**Kryesuesi:** A kemi ndonjë diskutim?... Nëse jo, atëherë e vendosim në votim, kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 23 vota “për” asnjë kundër dhe asnjë abstenim, votohet pika e gjashtë.

**7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për konstituimin e të drejtës së servitutit sendor (të drejtës së kalimit) në parçelen publike kadastrale, sipas certifikatës së pronësisë, P-71510032-00069-0, zk- Zoqisht;**

**Afrim Oruqi:** Bazuar në ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës, para jush e keni vendimin e propozuar nga kryetari i komunës për miratimin e të drejtës së kalimin në parçelen publike komunale me nr. 00069-0 – zk Zoqisht. Është parçelë me sipërfaqe të përgjithshme prej 94 ari e 89m. Pronat përrreth kësaj parcele që na dërgojnë në drejtim të rrugës kryesore Rahovec-Suharekë janë pa dalje. Atje në terren prej paraluftës janë duke e shfrytëzuar një korridor nëpër këtë parçelë të shkollës. Me nënshkrime të banorëve të këtij komuniteti ka kërkesë dhe gjithashtu në konsultim me drejtorin e shkollës, drejtorin e DKA-së, kryesinë e fshatit Zoqisht, e kemi marrur pëlqimin e tyre që t'i japim drejtkalimi pa e tjetërsuar pronën dhe duke mos e rrezikuar veprimtarinë e shkollës. Me gjerësi të përgjithshme prej 462m<sup>2</sup>, në gjatësi prej 94,98m, në gjatësi dhe gjerësi prej 5m.

**Defrim Kafexhiu:** E kam një pyetje për drejtorin! Kisha pasë dëshirë që ai ta shpjegojë më mirë këtë çështje, sepse këto dy vendime të tilla po vinë për herë të parë në këtë kuvend. Shpjegimi të jetë në një gjuhë më të thjeshtë. Te këto parçela, për ketë drejtë të shfrytëzimit që sipas ligjit i takon qytetarëve, a janë qytetarët që kanë bërë kërkesë, apo është komuna që po ia bënë këtë të mirë qytetarëve? Diçka tjeter, nëse vjen kërkesa prej qytetarëve, e lus kryetarin e komunës që të paktën ta bën një njoftim në faqen e Komunës së Rahovecit. Paraprakisht qytetarët të janë në dijeni që po iu garantohet me ligj kjo e drejtë e servitutit.

**Burim Krasniqi:** Bazuar në dokumentet e bashkëngjitura në propozim-vendim, i bie që rruga të jetë e ndarë në pjesën jug-perëndimore të parçelës. Sipas gjeoportalit, është një rrugë ekzistuese që shfrytëzohet momentalisht. Parcëla del përtëj që e kap edhe një objekt (që nuk shihet se çka është) rrugës dhe nëse rruga ndahet në kufij në parçelen, i bie që objekti duhet të rrënohet, apo hapësirë që pas objektit të nxjerrët kjo rrugë?

**Afrim Oruqi:** Të nderuar kuvendarë, bëhet fjalë për drejtkalim për banorët që nuk kanë qasje në rrugë. Ne po marrim vendim që t'i japim të drejtë banorëve të kalojnë në prona komunale. Qytetarët e Komunës së Rahovecit kanë të drejtë të bëjnë kërkesa të ndryshme. Kuvendi i komunës, bashkë me kryetarin, aty ku ka nevojë dhe mundësi, e propozon në kuvend dhe i jep drejtkalimi, pronari mbetet i njëjtë (Komuna e Rahovecit). Në pyetjet e kuvendarit z. Burim Krasniqi: Para se ta vendosim në rend dite këtë pikë, bashkë me gjeodetë dhe jurista kemi dalur në terren. Në gjeoportal mund ta shihni një objekt të vogël, i cili më herët është shfrytëzuar për thëngjill dhe dru, është i pashfrytëzueshëm. Prapa këtij objekti, komuna ka hapësirë më shumë se 5m dhe nuk do të rrezikohet aspak ky objekt.

**Drilon Mustafa:** Pëershëndetje! Drejtor, kjo parçela që do të lirohet, a do të shpronësohet, apo do ta merr statusin e rrugës? Në Drejtorinë e Urbanizmit kur dikush aplikon për leje, duhet të ketë qasje në rrugë publike, nëse ajo pjesë nuk shpronësohet që të bëhet rrugë, atëherë, Drejtoria e Urbanizmit nuk jep leje sepse nuk ka qasje në rrugë publike.

**Afrim Oruqi:** Faleminderit Drilon! Këto janë prona komunale, nuk do të kalojnë në proces të shpronësimit e as të këmbimit. Qytetarëve iu garantohet vetëm e drejta e kalimit, nuk mund ta bëjmë rrugë, sepse nuk është e paraparë me PZhK.

**Kryetari:** E përgëzoj drejtorin e Gjeodezisë, Kadastrës dhe Pronës. E inkurajoj që të jetë njëri nga ekspertët e Agjencisë Kadastrale të Republikës së Kosovës. Sqarimet i ka të thjeshta dhe të thukta. Faleminderit drejtor.

**Kryesuesi:** Gjithashtu edhe unë mendoj si kryetari. Nëse nuk kemi ndonjë diskutim tjeter, e vendosim pikën në votim. Kush është “për”?... Unanimisht me 25 vota “për” votohet pika e shtatë.

**8. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve;**

**Kryetari:** Ne kemi vendosur që nga seanca e qershorit, kjo pikë të jetë si e dyta në rend dite. E dini shumë mirë që unë nuk iki nga përballjet dhe debatet me juve. Sot, këta të bacës Avdi po më ftojnë në Odë, në anën tjeter kam ftesë nga një shoqatë tjeter, apo të rri këtu me juve. Nëse jeni dakord, pyetjet që është dashur t'i bëni sot, parashtroni në muajin qershor. Në mënyrë gjentëllmene, e kishim përmbyllur seancën. Dola t'ju kërkoj ndjesë që nuk mund të jem këtu, për shkak të aktiviteteve. Nëse jeni dakord, pyetje dhe diskutimet t'i bëni në qershor, kjo nuk domethënë

që mos t'i bëni pyetjet, mund t'i bëni edhe me shkrim. Me mirëkuptim, sot, të lirohemë të gjithë. Nuk do t'i ikim pyetjeve asnjëherë, e kemi edhe një vit e gjysmë mandat dhe këtu jemi.

**Kryesuesi:** Faleminderit kryetar! Atëherë, me lejen tuaj, pyetjet dhe përgjigjet t'i parashtoni në seancën e muajit qershor, për shkak të ngjarjes së sotme, shpalljes të Shtëpisë-muze të heronjve të Kosovës, Bedrush dhe Feim Gashit.

**Ilir Pallqa:** Kryetari mund të shkojë, komuna ka edhe nënkyretar. Ne mund ta vazhdojmë diskutimin, nënkyretari përgjigjet. Është mirë të vazhdojmë, nëse kemi diçka më nxeh të (vok'të), në seancën tjetër e diskutojmë.

**Kryetari:** Bashkë me titullin kampion të hendballit. I kemi dy ngjarje sot, ngjarje që nuk vijnë shpesh dhe kërkoj të na kurseni sot. Ju ftoj edhe juve të jemi bashkë në këto ngjarje. Ju ftoj që ta kursejmë njëri-tjetrin në kuptimin e kohës.

**Hasan Përboqi:** Për neve nuk është problem! Mund ta vendosim edhe votim kërkesën e kryetarit dhe jemi në rregull.

**Burim Krasniqi:** Në rregull! Si të doni. Nuk e kuptoj pse është nevoja për këtë format. A ka pyetje? Po ka! A ka nevojë që t'i bëjmë në një ambient të përshtatshëm? Po! Pas këtyre vendimeve relativisht po pajtohna. Te pyetjet me shkrim, nuk ka efekt, më mirë është të bisedoimë dreitnërdrejt.

**Seifullah Seifullahu:** Nga PDK, si te doni! Pér moment, kam nevoiē ta ushqe i lukthiñ, më pas vazhdoimë se saktan, kac ka cekta, me ninc esite te biscejmijet atejperdicijt.

**Leonard Morina:** Propozoj ta gjejmë një mes, kryetari le të shkon. Ne i bëjmë pyetjet, përgjigjet le të jenë me shkrim ose në seancën e radhës.

**Kryesuesi:** Nëse nuk keni pyetje tjera, me lejen tuaj, e quaj të mbyllur seancën e kuvendit për sot.

## Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi

